



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHE

# PAKETA FISKALE

## 2019

## A. Të përgjithshme

### A.1 Mbi Bashkinë Lezhë

Bashkia Lezhë kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.



Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia përbëhet nga 10 njësi administrative, të cilat janë: Lezha, Shëngjini, Zejmeni, Shënkolli, Balldreni, Kallmeti, Blinishti, Dajçi, Ungreji dhe Kolshi. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Lezhë dhe Shëngjin) dhe 65 fshatra.

*Tabelë 1. Ndarja në qytete dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë Lezhë*

Bashkia Lezhë	Qytetet dhe Fshatrat
Nj.A. Lezhë	Qyteti: Lezhë
Nj.A. Shëngjin	Qyteti Shëngjin, Fshatra: Ishull-Shëngjin, Ishull-Lezhe, Mali-Shëngjin, Mali-Rencit, Kodër Mulliri
Nj.A. Zejmen	Fshatra: Zejmen, Tresh, Pruell, Berzane, Pllanë, Markatomaj, Spiten
Nj.A. Shënkoll	Fshatra: Shënkoll, Rilë, Tale 1, Tale 2, Barbullojë, Grykë-Lumi, Gajush, Alk
Nj.A. Balldren	Fshatra: Balldren, Mali-Kakariq, Qëndër-Kakariq, Gocaj, Balldrën i Ri, Torovicë, Malecaj, Koljakaj
Nj.A. Kallmet	Fshatra: Kallmet i Madh, Kallmet i Vogel, Rraboshtë, Mërqi
Nj.A. Blinisht	Fshatra: Blinisht, Troshan, Fishtë, Krajnë, Piraj, Baqel, Kodhe
Nj.A. Dajç	Fshatra: Dajç, Gjadër, Gramsh, Mabë, Dragush, Kotërr, Zojs

Nj.A. Ungrej	Fshatra: Ungrej, Kashnjet, Gjobardhaj, Kalivaç, Ras-Butë, Zinaj, Fregen, Kaluer, Sukaxhi
Nj.A. Kolsh	Fshatra: Kolsh, Gjash, Kacinar, Patalej, Lalm, LalmLukaj, Velë, Manati, Grykë, Barbullojë e Re
<b>TOTALI</b>	<b>2 Qytete dhe 65 Fshatra</b>


Në territorin e bashkisë Lezhë, sipas ndarjes së re territoriale banon një popullsi prej 110,241 banorë, prej të cilëve 29,502 banojnë në qytetin e Lezhës dhe pjesa tjetër e shpërndarë në 9 Njësitë Administrative.

## A.2 Proçesi i Hartimit të Paketës fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Lezhë.

- Drejtoria e Buxhetit dhe Financës
- Drejtoria e Të Ardhurave Vendore
- Drejtoria Juridike
- Drejtoria e Palanifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban
- Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social
- Drejtoria e Bujqësisë, Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve
- Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit
- Drejtoria e Arsimit, Turizmit, Kulturës dhe Sportit
- Gjendja Civile
- Policia Bashkiake
- Administratorët e Njësive Administrative

### Hartimi i Paketës Fiskale 2018 kaloi nepërmjet etapave si më poshtë:



### Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Lezhë janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

(Permbledhje e organizimit të takimeve dhe propozimeve qytetare janë bashkëngjitur këtij Projekt-Propozimi).

#### A.3 Çfarë prezanton paketa fiskale?

Prezanton propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim me prioritetet e Strategjisë së Zhvillimit të Bashkisë Lezhë dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësia vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësive për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
  - ✓ Taksim i drejtë;
  - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
  - ✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
  - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

f) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësia (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

g) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

#### A.4 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Tatimi i thjeshtuar mbi BV;
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e pasurisë;
- ✓ Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- ✓ Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- ✓ Taksa e zënies së hapësirave publike;
- ✓ Taksa e tabelës/reklammat;
- ✓ Taksa të përkohshme;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

#### Ligje:

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr. 10354 , datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt. 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015;
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*"
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072,datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228,datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013;

- ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, date 27.11.2014;
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
  - ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, ”Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”;
  - ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, ”Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”;
  - ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 date 11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011 ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012 ndryshuar me Ligjin Nr. 120/2013, datë 18.04.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014;
  - ✓ Ligji nr. 93/2015 “Për turizmin”;
  - ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar;
  - ✓ Ligji Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
  - ✓ Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”;
  - ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar;
  - ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”;
  - ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar;
  - ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”;
  - ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe LigjinNr.9797, datë 23.7.2007;
  - ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”;
  - ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
  - ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Ligji Nr.106/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 9632,date 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar.

#### **Vendime dhe udhëzime:**

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 “Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”;
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, ”Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, ”Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare”, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” ;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 21.6.2006 “Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 “Për tarifatat në sektorin e Kullotave”,

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr.1064 datë 22.12.2010 *“Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 *“Për përcaktimin e kritereve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 992, datë 9.12.2015 *“Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, të ndryshuar;
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.469, datë 3.6.2015, *“Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 *“Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 285, date 27.6.2002 *“Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 *“Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave te Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”;*
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.132,date 7.03.2018 *“Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “NDËRTEESA”, e bazës së taksës për kategori specifike,natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe të kritereve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”.*
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 *“Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor”;*
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, *“Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël”*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, *“Për taksat kombëtare”*, i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 *“Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore “;*
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 *“Për zbatimin e vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apokontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, I ndryshuar;*
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 *“Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 “Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme”;*



## B. Paketa Fiskale

### Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore duke u nisur nga elementët:

- Lloji, niveli i taksës, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

#### I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

**Baza e taksës/tatimi:** Këstet e parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, llogariten në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

**Niveli i tatimit:** Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

*Tabelë 2. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël*

I.1	Shkalla tatimore	Njesia	Niveli Ligjor/Detyrimi	
			NjA Lezhe	NjA te tjera
A	Me qarkullim vjetor nga 0 – 5.000.000 lekë	lekë/vit	0	0
B	Me qarkullim vjetor nga 5.000.001–8.000.000 lekë	lekë/vit	5% e fitimit	5% e fitimit

#### Mënyra e pagesës:

Tatimpaguesi parapaguan, në llogarinë e organeve tatimore ose në Postën Shqiptare, këstet tremujore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të biznesit të vogël, brenda datës 20 prill, për muajt: janar, shkurt e mars; brenda datës 20 korrik, për muajt: prill, maj e qershor; brenda datës 20 tetor, për muajt: korrik, gusht e shtator; dhe brenda datës 20 dhjetor, për muajt: tetor, nëntor dhe dhjetor.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tatimit :**Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

Për këtë shërbim Drejtoria Rajonale e Tatimeve Lezhë përfiton një komision prej 1 % të të ardhurave të mbledhura.

#### I.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.



Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

### I.2.1 Taksa mbi ndërtesat

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Dokumentat që vërtetojnë pronësinë janë: Çertifikata e Pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit Pronave, Vendimi i Privatizimit etj.dokumenta, konform legjislacionit në fuqi.

**Niveli i taksës mbi ndërtesat:** Niveli për kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

**Tabelë 3. Taksa mbi ndërtesat**

Nr.	Kategoritë dhe nënkategoritë	Njësia	Niveli i Taksës mbi ndërtesat			
			NjA Lezhe		NjA te Tjera	
			Sipas ligjit	Propozimi	Sipas ligjit	Propozimi
<b>I.2.1</b>	<b>Ndërtesa banimi</b>					
a	Ndërtuar para dhe pas vitit 1993	lekë/m2/vit	28	24	28	20
b	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi	lekë/m2/vit	28	24	28	20
c	Ndërtesa të dyta banimi (për të gjitha shtëpitë e tjera)	lekë/m2/vit	28	28	28	28
<b>I.2.2</b>	<b>Ndërtesa të tjera</b>					
a	Për tregti dhe shërbime - Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, social kulturore, arsimore e shkencore.	lekë/m2/vit	168	160	168	120

b	Të tjera - Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve	lekë/m2/vit	60	42	30	28
c	Parkingje te mbuluara,bodrume etj.	lekë/m2/vit	78.4	70	78.4	70
d	Parkingje te zbuluara,kalceto te pambuluara etj.	leke/m2/vit	33.6	30	33.6	30
e	Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi	lekë/m2/vit	168	160	168	120

Në aplikimin e taksës së ndërtesës, jemi bazuar mbi çmimet referuese të ndërtesave në territorin e bashkisë Lezhë, sipas aneksit 1 të VKM Nr. 132. cili per bashkine Lezhë është 56,000 lekë/m2. Duke aplikuar këtë ulje, niveli i taksës së banesës për familjet që banojnë jashtë qyteteve Lezhë dhe Shëngjin propozohet të jetë 20 lekë/m2/vit.

### **Kategoria I.2.1 Ndërtesa banimi**

**Përfshihen:** Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllim jo fitimprurës nga qytetarët, por vetëm për qëllim banimi.

### **Kategoria I.2.2 Ndërtesa të tjera**

Përfshihen:

#### **a) Nënkatëgoria: ndërtesa për tregti dhe shërbime:**

- *Ndërtesa për shërbime shëndetsore, artizanale, socialkulturore, arsimore e shkencore.* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat (farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve dhe njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, etj. të ngjashme me to). Shkollat, kopshtet, çerdhe, qendra kulturore, qendra sociale, stadione, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura, ndërtesa shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, interneti, sallat e koncerteve, videoteka, etj.
- *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative, etj. të ngjashme me to:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, bankat, zyrat, njësi tregtare dhe shërbimi të cdo lloji etj., të ngjashme me to.
- *Ndërtesa të tjera:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë më sipërme.

### **b) Nënkatëgoria: të tjera**

- *Ndërtesa prodhimi:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plazmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunimvajrash, nafte, etj, shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.
- *Ndërtesat në pronësi të organizatave jo fitimprurëse, fondacioneve;* Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jo fitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të rregjistruara si të tilla në gjykatë.
- Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit, kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet. Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë capital i Ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qënë kapitali ish-ndërmarrjeve shtetërore:
- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese, të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80% e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qënë objekt i ish-ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuar (vlera e amortizimit mbi 80% e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Për ato kategori ndërtesash banimi, të cilat janë të rregjistruara si seli të subjekteve tregtare, taksa e pasurisë përllogaritet dhe paguhet si Kategoria I.2.2, ndërtesa të tjera sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë, duke u përjashtuar nga Kategoria e I.2.1, Ndërtesa Banimi.

### **Kategoria I.2.3. Fshatra turistike**

Përfshihen të gjithë taksapaguesit, të cilët kanë në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

#### **Menyra e pageses:**

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për të gjitha kategoritë e biznesit ky detyrim **paguhet me një këst**. Afati i pagesës është data 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Qershor 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

Për familjarët që kanë kontratë me Ujësjetellës-Kanalizime Sh.A. taksa e ndërtesës do të paguhet me 10 këste të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Kurse për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujësjetellës-Kanalizime Sh.A., taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm, në të njëjtën kohë me Tarifën e Shërbimit Publik dhe Taksën e Tokës Bujqësore për familjet që banojnë në fshat.

Çdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do llogaritet duke marrë për bazë sipërfaqen prej 100 m2 (prezypimi i sipërfaqes) për çdo rast. Ne rolin e agjentit tatimor,Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A. do të marrë një komision,i cili përcaktohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet dy institucioneve përkatëse.

### **Përfshirje:**

Përfshihen nga pagesa e taksës:

- Pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore qe perdoren per qellime jo fitimprures,
- Ndërtesat e banimit që shfrytesohen nga qirramaresit me qera të pa liberalizuara,
- Ndërtesat që perdoren nga komunitetet fetare.
- Pasuritë në pronësi të shtetit,të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave,nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- strukturat akomoduese “Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special”, sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtes të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht “brand name”;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja përbëhet vetëm nga pensionistët;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore

### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për biznesin e të gjitha kategorive është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

Për vjeljen e taksës së ndërtesës për qëllime banimi,ngarkohet Ndërmarrja Ujësjiellës Kanalizime SH.A.Lezhë për vjeljen e taksës së ndërtesës për familjarët që kanë kontratë me Ujësjiellësin.

Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjiellës-Kanalizime Sh.A.struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takes është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë,në bashkëpunim me njësitë administrative përkatëse.

### **I.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore**

**Përkufizimi:** “*Tokë bujqësore*” është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronesisë, formularit nr.6, aktit të pronesisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

**Niveli i taksës mbi tokën bujqësore** paraqitet si më poshtë:

*Tabelë 4. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore*

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Për të gjitha Nj.A.	
		Sipas Ligjit	Propozimi
I	Lekë/ha/vit	5,600	3,920
II	Lekë/ha/vit	4,900	3,430

<b>III</b>	Lekë/ha/vit	4,200	2,940
<b>IV</b>	Lekë/ha/vit	3,600	2,520
<b>V</b>	Lekë/ha/vit	3,000	2,100
<b>VI</b>	Lekë/ha/vit	2,400	1,680
<b>VII-X</b>	Lekë/ha/vit	1,800	1,260

### Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi token bujqësore është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim **paguhet me nje këst**. Afati i pagesës është data 30 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 31 Maj është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit të pronave sqarojmë se: përpersonat që i zoterojnë këto pronat aplikohet taksa sipas natyrës së pronës, nëse është tokë bujqësore, trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive sipas ligjeve në fuqi.

### Përfundime:

Tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

### Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi token bujqësore për të gjitha kategoritë është Njësia Administrative perkatese në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë. Bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë, të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

### I.2.3 Taksa mbi truallin

**Përkufizimi:** Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

**Niveli i taksës mbi truallin** paraqitet si më poshtë:

*Tabelë 5. Niveli i taksës mbi truallin*

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin	
		Për të gjitha Nj.A.	
		Sipas Ligjit	Propozimi
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	0.56	0.56

Për qëllime biznesi	Lekë/m <sup>2</sup> /vit	20	20
---------------------	--------------------------	----	----

### Menyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje kest. Afati i pagesës është data 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 31 Maj është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për të gjitha kategoritë është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

## I.3. Taksa e fjetjes në hotel

**Përkufizimi:** Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a) "Bujtinë"; b) "Fjetinë" (Hostel); c) "Kamping"; ç) "Hotel"; d) "Motel"; dh) "Resort"; e) "Qendër kurative"; ë) "Fjetje dhe mëngjes" (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: "Bujtinë" Standard, "Fjetinë" Standard, Komfort; "Kamping" Standard, "Hotel" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Motel" Standard, Komfort, Superior; "Resort" tre yje, katër yje, pesë yje; "Qendër kurative" dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; "Fjetje dhe mëngjes" (B&B) Standard, Komfort, Superior.

**Baza e taksës:** Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

**Tabelë 6. Taksa e fjetjes në hotel**

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel	
		Për të gjitha Nj.A.	
		Sipas Ligjit	Propozimi
Hotel me 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi/për person	175	140
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	Lekë/natë qëndrimi/për person	70	70

### Menyra e pagesës:

Pagesa kryhet brenda dates 5 të muajit pasardhës. Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli perlllogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës së fjetjes në hote

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë në bashkepunim me njesine administrative. Bashkëpunimi me Njësitë Administrative rregullohet me rregullore të veçantë.

#### I.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

**Baza e taksës:** Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

**Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë** sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

*Tabelë 7. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë*

Nr	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njesia matjes	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë			
			Nj.A. Lezhe		Nj.A të tjera	
			Sipas ligjit	Propozimi	Sipas ligjit	Propozimi
1	1.a Ndërtime për njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik.	Në % të çmimit të shitjes për m <sup>2</sup>	4-8%	4%	4-8%	6%
	1.b Për ndërtime për qëllime banimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është			4%		
2	Për ndërtime për qëllime banimi (shtëpi banimi private), me investiture familjare	Në % të çmimit të shitjes për m <sup>2</sup>	1-3%	2%	1-3%	
2	Ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër.	Në % të kostos së ndërtimit	1-3%	3%	1-3%	
3	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	Ne % të vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukture së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0,1%	0.1%	0,1%	
4	Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	Ne % të kostos së ndërtimit	0.5%	0.5%	0.5%	

**Baza e taksës (per piken 1):** Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësisë të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së



tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

**Baza e taksës** (per piken 2, 3, 4): Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

**Mënyra e pagesës:**

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet,duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë,ndaj çmimit te shitjes për meter katror ose vlerës se investimit.

Në rastet kur një ndërtesë ka funksione të përziera (banim dhe administrative,etj,përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet,duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë, ndaj çmimit te shitjes për metër katrorë respective të pjesës së banimit dhe atë administrative,shërbimi,etj.

**Lehtësirat tatimore:**

Përfshirë për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare,të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastructures në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte,taksa e ndikimit në infrastructures të ndërtimeve të reja është 0,1 përqind e vlerës së investimit,por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastructures së dëmtuar, kur kostoja nuk është e përfshirë në preventivin e investimit.

**Strukturat përgjegjëse përvjeljen e taksës:**

Struktura e ngarkuar për përlllogaritjen dhe lëshimin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastructures nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Lezhë.

**I.5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme**

**Baza e taksës** mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

**Niveli i taksës:** Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

*Tabelë 9. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme*

Kategoritë e ndërtesave	Njësia matjes	Niveli i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme			
		Nja Lezhë		Nja te Tjera	
		Sipas Ligjit	Propozimi	Sipas Ligjit	Propozimi
Ndërtesa banimi	Lekë/m2	300	300	100	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m2	700	600	300	300

Ndërtesa të tjera	Lekë/m <sup>2</sup>	500	400	200	200
-------------------	---------------------	-----	-----	-----	-----

### **Mënyra e pagesës:**

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Niveli i taksës caktohet në lek/m<sup>2</sup> të bazës së taksës. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

### **Përfshirjet:**

1. Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:
  - a) Enti Kombëtar i Banesave, Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore;
  - b) Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”;
  - c) Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
    - i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
    - ii) Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak ose komunal për përfshirjen nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

2. Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi

### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:**

Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar, diferenca kalon për llogari të buxhetit vendor jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.

Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave pranë Bashkisë Lezhë të bëjë rakordimet me ZVRPP Lezhë dhe planifikimin e të ardhurave.

## **I.6. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura**

**Baza e taksës:** është lloji i mjetit të transportit rrugor.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, njëzetepesë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Lezhë në llogarinë e degës së thesarit.

## **I.7. Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare**

**Baza e taksës:** Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:** Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor. Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Lezhë ne llogarinë e degës së thesarit.

### I.8. Taksa e përkohshme për arsimin

Kjo është një taksë e përkohshme, së cilës do t'i nënshtrohen të gjitha subjektet fizike dhe juridike që ushtrojnë aktivitet në territorin e bashkisë Lezhë. Kjo taksë do të përdoret ekskluzivisht për përmirësimin e infrastructures së objekteve arsimore në bashkinë Lezhë. Niveli i kësaj takes do të jetë:

Për biznesin e madh: 6,000 lekë/vit  
Për biznesin e vogël: 3,000 lekë/vit

#### Menyra e pagesës:

Detyrimi për taksën e përkohshme në arsim është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 30 Qershor është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

### I.9. Taksa e tabelës

**Baza e taksës:** Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve. Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

*Tabelë 10. Taksa e tabelës*

Nr.	Lloji tabelës	Njësia	Niveli i taksës së tabelës	
			Sipas Ligjit	Propozimi
			Për të gjitha NjA	
<b>I.</b>	Tabelë për qëllime identifikimi, të trupëzuara ose jo , brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.	lekë/ m2/vit		
<b>a</b>	<b>Sipërfaqe deri në 2 m2</b>	lekë/ m2/vit	0	0
<b>b</b>	<b>Siperfaqe nga 2-10m2</b>	lekë/m2/vit		
	-E thjeshtë ( pa ndriçim)		10.000	10,000

<b>c</b>	-Me ndriçim të thjeshtë -Elektronike		15.000 20.000	15,000 20,000
	<b>Siperfaqe nga 10m2-20m2</b>		8.500	8,500
<b>ç</b>	-E thjeshtë ( pa ndriçim)		12.750	12,750
	-Me ndriçim të thjeshtë -Elektronike		17.000	17,000
	<b>Siperfaqe mbi 20m2-40m2</b>			
<b>d</b>	-E thjeshtë ( pa ndriçim)		5.500	5,500
	-Me ndriçim të thjeshtë		8.250	8,250
	-Elektronike		11.000	11,000
	<b>Siperfaqe mbi 40m2</b>			
<b>d</b>	-E thjeshtë ( pa ndriçim)		4.000	4,000
	-Me ndriçim të thjeshtë		6.000	6,000
	-Elektronike		8.000	8,000
<b>II</b>	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim	Lekë/m2/vit	120	120
<b>III</b>	Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme dhe e palëvizshme deri në tavanin maksimal 35 m2:			
	Tabelë e thjeshtë (me /pa ndriçim)	lekë/ m2/vit	22,500	22,500
	Tabelë elektronike	lekë/ m2/vit	45,000	31,500
<b>IV</b>	Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj	lekë/ m2/ditë	1,000	1,000

### Menyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi tabelen është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst. Afati i pagesës është data 30 Prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 30 Prill është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë, në bashkëpunim me njesinë administrative.

### I.10. Taksa e perkohshme për mbushje ose heqje dheu në sipërfaqen truall

**Baza e taksës:** Është sipërfaqja e truallit që mbushet ose i hiqet dheu

**Niveli i taksës:** Niveli i takses është 50.000 leke/dynym.

### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës së përkohshme për mbushje ose heqje dheu në sipërfaqen truall është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë.

#### **I.11. Taksa e përkohshme për infrastrukturën nëntokësore (telefoni, energji, tv kabllor, gaz, ujësjelles)**

**Baza e taksës:** Është gjatësia në Km e infrastrukturës nëntokësore, e cila vihet në shfrytëzim nga subjektet për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, duke shumezuar bazën e taksës me gjatësinë e infrastrukturës nëntokësore.

**Niveli i taksës** është 500 leke/m<sup>2</sup>.

### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Taksës së përkohshme për infrastrukturë nëntokësore është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë. Afati i pagesës është data 30 Prill.

## Kapitulli II: TARIFAT VENDORE

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, nivelit të tarifës bazuar në koston e shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### II.1. Tarifa e shërbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, gjelberimit, ndriçimit dhe dekorit)

**Përkufizimi:** Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Lezhë dhe njësisë të saj administrative. Tarifa e shërbimeve publike paguhet nga familjarët, personat fizikë e juridikë për çdo vendndodhje të tyre.

**Niveli i tarifës së shërbimeve publike:** Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

*Tabelë 11. Tarifa e shërbimeve publike*

Nr	KATEGORITE	Niveli tarifës së shërbimeve publike					
		Zona A		Zona B		Zona C	
		0-8 milion	Mbi 8 milion	0-8 milion	Mbi 8 milion	0-8 milion	Mbi 8 milion
		Leke/vit		Leke/vit		Leke/vit	
I	FAMILJARET (për familje)	3000		1800		1,800	
II	BIZNESI						
II.1	SHITJE ME PAKICË						
	Mish	10,000	40,000	5,000	15,000	4,000	12,000
	Peshk	10,000	50,000	7,000	20,000	5,000	15,000
	Bulmet, fruta, perime, ushqimore e artikuj të ngjashëm	10,000	50,000	7,000	20,000	5,000	14,000
	Artikuj industrial (veshje parfumeri, argjendari etj.)	5,000	27,000	5,000	15,000	3,000	10,000
	Bar kafe	10,000	32,000	5,000	15,000	3,000	12,000
	Restorant, fastfoode, etj. të ngjashme me to	15,000	40,000	10,000	20,000	7,000	15,000
	Pub, diskoteka, etj. të ngjashme	10,000	32,000	7,000	15,000	5,000	12,000
	Kafe internet, qendra interneti	10,000	32,000	5,000	15,000	3,000	12,000

	Njesi tregtimi lendesh djegese, hidrokarbure, karburante ,etj. Të ngjashme me to.	10,000	50,000	5,000	15,000	3,000	12,000
	Shitje produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to	10,000	27,000	5,000	15,000	3,000	10,000
	E te tjera te ngjashme me to	5,000	27,000	5,000	15,000	3,000	10,000
<b>II.2</b>	<b>SHITJE ME SHUMICË</b>						
	Magazina, dyqane, etj. te cilat realizojnë shitje me shumice	15,000	50,000	10,000	20,000	7,000	15,000
<b>II.3</b>	<b>NJESI PRODHIMI</b>						
	Perpunim duralumini, metalesh, druri, tapicerie, letre, kartoni, plasmasi, etj. te ngjashme me to	20,000	47,000	7,000	25,000	5,000	15,000
	Prodhim tulla, tjegulla, blloqe betoni, furra gelqereje, nyje inerte, te ngjashme me to	20,000	100,000	10,000	30,000	7,000	20,000
	Prodhime ushqimore, buke, embelsirash, mishi, peshku, bulmeti, pijesh etj. të ngjashme me to.	10,000	50,000	7,000	25,000	5,000	15,000
	Perpunim mish, peshk, etj. të ngjashme me to	50,000	200,000	7,000	30,000	5,000	20,000
	Prodhim konfeksione, etj. te ngjashme me to.	10,000	80,000	7,000	25,000	5,000	15,000
	Prodhim, perpunim vajrash, nafte, gazi e nenprodukte, etj. te ngjashme me to.	10,000	47,000	7,000	25,000	5,000	15,000
	Impiante, territore per therrjen e kafshëve	25,000	200,000	15,000	30,000	12,000	20,000
	Shtypshkronja, etj. te ngjashme me to.	15,000	40,000	10,000	25,000	7,000	5,000
	Impiante, linja për prodhim dhe përpunimin e produkteve ushqimore ose të tjera.	20,000	50,000	7,000	20,000	5,000	15,000
	Prodhim-perpunim produkte farmaceutike	5,000	42,000	5,000	20,000	3,000	15,000
<b>II.4</b>	<b>SUBJEKTE NDERTIMI</b>						



	Njësi ndërtimi për çdo kantjer ndërtimi, -Deri ne 5 kateshe -mbi 5 kateshe	20,000 30,000	50,000 250,000	15,000 20,000	35,000 100,000	10,000 15,000	25,000 70,000
	Rikonstruksionet e pjeseshme	10,000	60,000	7,000	30,000	7,000	20,000
	Subjekte Ndertuese per selinë administrative	5,000	30,000	5,000	15,000	3,000	10,000
<b>II.5</b>	<b>NJESI SHERBIMI</b>						
	Riparimi i artikujve elektro-shtepiake,radio televizore,frigorifere,lavatriçe,	20,000	40,000	7,000	15,000	3,000	7,000
	Sherbime agjensi kembimi valute, agjensi turizmi,agjensi sigurimesh etj .te ngjashme me to	10,000	20,000	5,000	10,000	3,000	7,000
	Sherbime fotokopimit,sallon bukurie, autoservise,kurse per makina(autoshkolla) per traktore,per kompjuter e per parukeri, agjenci doganore,sherbime kredi dhenie, sherbime bankare,sherbimet per konviktet,pikat e sherbimit te makinave (autoservis),parkimi i makinave,agjenci transporti,lavanterite,pastrimiki mik, sherbimete rojevecivile,sallat e lojrave te ndryshme(gjmnastike,aerobie, cirqe,kende lojrash per femije,pingpong,etj.)e te tjera sherbime te ngjashme me sherbimet me siper.	10,000	35,000	5,000	20,000	3,000	15,000
	Hotele,motele (leke/dhome ne vit)	1,000	2,000	300	500	100	200
	Njësi shërbimi marangoz, rrobaqepës,këpucar,floktore, orëndreqës	10,000	35,000	5,000	20,000	3,000	15,000
	Komplekse sportive,palestra,fitnes,pishina, qendra e institute kerkimore-shkencore,salla koncerte-mbledhje e videoteka	10,000	37,000	7,000	20,000	5,000	12,000

	Lojra me kompjuter, lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura	5,000	42,000	5,000	15,000	3,000	12,000
<b>II.6</b>	<b>SHOQATA, FONDACIONE, ORGANIZATA JO QEVERTARE.</b>		20,000		10,000		10,000
<b>II.7</b>	<b>ENTE TË NDRYSHME SHTETËRORE Leke/m2/vit</b>		150		100		100
<b>II.8</b>	<b>PROFESIONE TE LIRA</b>						
	Avokatet, noteret, mjeket, mjeku -laborant, stomatologu, ekonomist kontabël të miratuar, mësuesit, veterinerët, agronomët ,botuesit, inxhinier, arkitektë, projektuesi, e te tjera profesione te lira te cilat ushtrohen ne njësi fikse apo ne ambiente te ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to.	5,000	17,000	5,000	10,000	3,000	7,000
	Galeritë e artit te piktoreve, skulptoreve dhe artisteve te tjerë qe prodhojnë dhe tregtojnë objekte artistike	5,000	15,000	5,000	7,000	3,000	5,000
	Institucionet jo publike te edukimit (shkollat, kopshtet apo çerdhet), shërbimet ne klinikat e specialiteteve te ndryshme mjekësore, shërbimet ne laboratorë diagnostifikimi	5,000	17,000	5,000	10,000	3,000	7,000
<b>II.9</b>	<b>AMBULANT</b>						
	Subjekte qe nuk kane një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante ne tregje publike dhe private.	2,000	2,000			2,000	
	Ambulante ne Shengjiin						
<b>II.1</b>	<b>TRANSPORT</b>						
	<b>Transport pasagjerësh</b>	2,000	15,000	2,000	7,000	2,000	5,000
	Automjet deri 5 vende						
	Automjet 6-9 vende						
	Automjet 10-25 vende						
	Automjet 26-42 vende						
	Automjet mbi 42 vende						
	<b>Transport Mallrash</b>	3,000	18,000	3,000	7,000	3,000	5,000

	Automjet deri 2 tonë						
	Automjet 2-5 tonë						
	Automjet 5-10 tonë						
	Automjet 10-16 tonë						
	Automjet mbi 16 tonë						
	<b>Transport Ujor</b>	5,000	22,000	5,000	10,000	3,000	7,000
	Transport detar Brenda vendit						
	Transport në liqene Brenda						
	Varka për shetitje		25,000				
	Peshkim e te tjera te ngjashme	5,000	10,000	5,000	7,000	3,000	5,000
II.1	<b>TË TJERA</b>	5,000	10,000	5,000	7,000	3,000	5,000

Tarifa e Shërbimit Publik për bizneset e të gjitha llojeve do të kryhet me një këst të vetëm, të përfshirë në Faturën për Arkëtim, të nxjerrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Për familjarët që kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Tarifa e Shërbimit Publik do të paguhet me 12 këste të barabarta nga 250 lekë/muaj, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm. Kurse për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujësjellës-Kanalizime Sh.A., taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm, në të njëjtën kohë me Taksën e Ndërtese Taksën e Tokës Bujqësore për familjet që banojnë në fshat.

Ne rolin e agentit tatimor, Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. do të marrë një komision, i cili përcaktohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet dy institucioneve përkatëse.

**Zona A ka këte shtrirje:** Godina e NjA Kolsh, qyteti Lezhe, mbikalimin e shinave të trenit, ura e Drinit (Lezha Petrol), Qyteti Shëngjin, Rana e Hedhun, Segmenti nga Lapidari deri në Kune, Koder Marlekaj, Pusi i Shytit, Varrezat, Zona e vijës së parë në të dy anët e autostradës Tiranë-Shkodër.

**Zona B:** NjA Balldre, NjA Kolsh, NjA Zejmen, NjA Shenkoll, fshatrat Ishull Lezhë dhe Ishull Shëngjin të NjA Shëngjin

**Zona C:** NjA Dajç, NjA Blinisht, NjA Ungrej, NjA Kallmet

#### **Mënyra e pagesës:**

Detyrimi për Tarifën e Shërbimeve është vjetor.

#### **Kategoria I. "Familjarët":**

Detyrimi paguhet me këste mujore të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, për klientët e Ujësjellës-Kanalizime Sh.A. Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjellësin paguhet me një këst të vetëm pranë Njësisë Administrative ku banojnë. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 60 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën kjo kategori duhet të paraqesë pranë zyres së taksavetë Bashkisë çertifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

#### **Kategoria II. "Biznesi":**

Detyrimi paguhet brenda dates 30 Prill 2019. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 31 Maj është 60 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKR.

Për kategorinë **II.1“Subjekte Ndërtimi”** nënkategorinë “Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj. të ngjashëm me to “Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi e tregtare, etj. të ngjashëm me to”, llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Lezhë të kërkesës për leje shfrytëzimi. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

**Për të gjitha kategoritë:**

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë, gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

**Përjashtime:**

Përjashtohen nga pagesa e tarifës së shërbimeve:

- Familjet që kanë k/familjarin invalid;
- Familjet që kanë në perberjen e tyre të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë,
- Familjet që janë perfituese të ndihmës ekonomike;
- Pensionistët e vetëm ose me persona madhore të papunë

Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat e mëposhtëm:

1. Çertifikatën familjare,
2. Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit,
3. Librezën për paraplegjikë e tetraplegjikë, librezën e pensionit
4. Vërtetimin nga Bashkia për përfituesit e ndihmës ekonomike

**Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:**

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës së Shërbimeve Publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me njësinë administrative.

**II.2. Tarifa për zënien e hapësirave publike**

Kategoritë dhe nënkategoritë e tarifave për zënien e hapësirave publike sipas zonave të banimit jepen si në tabelën e mëposhtme:

*Tabelë 12. Tarifa për zënien e hapësirave publike*

KATEGORIA DHE NË NKATEGORITË	Njesia matjes	Niveli i tarifës për zënien e hapësirave publike	
		NjA Lezhe/Shen gjin	NjA te Tjera

1.	Zënia e hapësirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregimit, vendosje tavolinash sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bime dekorative, me kangjella, drurë dekorativ, kufizime me plasmasë dhe te tjera te ngjashme me keto.	Lekë/ m2/muaj	500	200
2.	Zënie e hapsirave publike n plazhe : a) Per qellime biznesi, si vendosje lodra per femije, kjoske, vendosje tavolinash etj. të ngjashme me këto	Lekë/ m2/sezon	500	300

Për zënie e hapësirave publike me qëllim vendosjen e shezllongjeve në plazhe,do të pajisen me sipërfaqe rëre **vetëm subjektet që kanë kapacitete akomoduese për pushuesit**,duke aplikuar raportin 1(një) çift shezllongjesh/dhomë pushuesish ose 10 m2 sipërfaqe rëre për çdo apartament që jepet me qera për pushuesit.

Autorizohet Kryetari i Bashkisë per ngritjen e komisionit për përcaktimin e sipërfaqes së zene te hapsirës publike.

Komisioni percakton madhësinë e sipërfaqes së zënë dhe kohën e përdorimit të saj. Pagesa kryhet para lidhjes së kontrates.

### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë, ne bashkepunim me njesine administrative.

### II.3. Tarifa e parkimit të automjeteve

Tarifa për parkimin e automjeteve në vendparkime publike me pagesë dhe tarifa për vendqëndrime të mjeteve të liçensuara - taksi, caktohet:

*Tabelë 13. Tarifa e parkimit*

KATEGORIA	Tarifa për parkim në vendet e miratuara me pagesë ( vija blu)	Tarifa per vendqendrim (vija te verdha) Leke/vit	Tarifaper parkimet e rezervuara (vija te verdha)
Autobuse të linjave nderqytetese		25,000	
Autobuse të linjave rrethqytetese		15,000	
Autobuse të linjave të rregullta të specializuara		10,000	
Autovetura	50 lek/orë		36,000
Taksi 4+1		8,000	
Taksi 8+1		10,000	

Automjete të transportit të perzier deri 3.5 ton		15,000	
Automjete të transportit të mallrave mbi 3.5 ton		25,000	
Tarife parkimi per automjetet elektrike	0	0	0

Subjektet e biznesit të vogël mund të marrin leje parkimi **vetëm për një vendparkim**, ndërsa subjektet e biznesit të **madh jo më shumë se 2 vende parkimi**.

Kontratat per vendparkimet e rezervuara nuk mund të lidhen per nje periudhe kohore me te shkurter se 6 muaj.

#### Mënyra e pageses:

Të gjithë subjektet që përfitojnë nga rezervimi i vendparkimeve të miratuara janë të detyruar të lidhin kontratë me Drejtorinë Juridike pranë Bashkisë Lezhë, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga strukturat e transportit pranë Bashkisë.

#### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Shërbimeve Publike (për parkimet e rezervuara të autoveturave dhe parkimet me pagese-vija blu) dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për tarifën e tjera të parkimit.

Drejtorja e Shërbimeve është përgjegjëse për dhenien e lejes së parkingut te rezervuar. Drejtoria Juridike harton kontratën tip për parkimet e rezervuara.

## II.4. Tarifaper shërbimet administrative nga Bashkia Lezhë

### II.4.1 Tarifa të urbanistikës

Grupi i tarifave të mëposhtëme aplikohet për shërbimet që banorët/subjektet marrin nga Bashkia për çështje që lidhen me zhvillimin urbanistik.

*Tabelë 14. Tarifa e shërbimeve administrative*

Nr	Llojet e tarifave	Njesia e matjes	Tarifa per shërbime adminstrati
1	Pranim dosje per shqyrtim për të gjitha llojet e aplikimeve		
1.1	Për nevoja biznesi	Lekë/dosje	10,000
1.2	Per shtepi banimi	Lekë/dosje	2,000
1.3	Për ndryshim destinacioni	Lekë/dosje	5,000
1.4	Tarifë për punime që kërkojnë deklaratë		3 % e preventivit te punimeve,por jo me pak se 10.00 lekë

2	Njehsim i dokumenteve me origjinalin	Lekë/dokument	100
3	Per fasaden e objekteve	Lekë/m2	30
4	Kontroll i piketimit të rrethimit	Lekë/kontroll	5,000
4	Kontroll i piketimit te objekteve	Lekë/kontroll	5,000
5	Kontroll pas perfundimit te themeleve	Lekë/kontroll	5,000
6	Kontroll pas perfundimit te karabinase	Lekë/kat	10,000
7	Kontroll mbi sistemimin e ambientit rrethues	Leke	5,000
8	Akt kontrolli perfundimit te punimeve për leje perdorimi	Lekë/m2	50
9	Azhornim genplanesh per leje ndertimi	Lekë/m2	40
10	Matje e percaktim i zones se vendndodhjes se objektit,	Lekë/dokument	3,000
11	Punime rikonstruksioni ne godinat ekzistuese per familjare	Leke	3% e vleres se preventivit te punimeve por jo me pak se 10,000 leke
12	Punime rikonstruksioni ne godinat ekzistuese per shoqeri ndertimi	Leke	3% e vleres se preventivit te punimeve por jo me pak se 10,000 leke
13	Tarife per lejen e kioskave provizore	Leke	100,000
14	Azhornime per reklama e zenie hapësirash publike	Lekë/dokument	2,000

### Strukturat përgjegjëse përvjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifave është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Lezhë

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e urbanistikës është Drejtoria e Urbanistikës.

### II.4.2 Tarifa të shërbimit veteriner

*Tabelë 15. Tarifa e shërbimit veteriner*

Nr	Tarifat për therje	Njesia e matjes	Tarifa e shërbimit
1	Për çdo gjedh të therur	Lekë/kokë të therur	100
2	Per çdo derr të therur	Lekë/ kokë të	100
3	Per çdo të imet te therur	Lekë/koke te therur	50
4	Per çdo parti peshku të	Lekë/njesi tregtare	100



## Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës:

Struktura e ngarkuar për lëshimin e autorizimit të pagesës për tarifën e shërbimit veteriner është Sektori i Inspektoriatit Veterinar.

### II.5. Tarifat e liçensimit të transportit të udhëtarëve

*Tabelë 16. Tarifa e licencimit të transportit të udhëtarëve*

Nr	Kategorite	Njësia e matjes	Tarifa e liçensimit të transportit udhëtarëve
A	Liçense për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Leke/5vjet	40,000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Leke/mjet/vit	1,000
3	Liçense për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Leke/5 vjet	20,000
4	Çertifikate për transport udhëtarësh në linjë të rregullt rrethqytetëse	Leke/mjet/vit	1,500
5	Liçense për transport udhëtarësh në linjë të rregullt nderqytetëse Brenda	Leke/5 vjet	75,000
6	Çertifikate për transport udhëtarësh në linjë të rregullt nderqytetëse brenda	Leke/mjet/vit	1,500
7	Liçense për transport udhëtarësh në linjë të rregullt nderqytetëse ndermjet	Leke/5 vjet	75,000
8	Çertifikate për transport udhëtarësh në linjë të rregullt nderqytetëse ndermjet	Leke/mjet/vit	1,500
9	Liçense për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi Brenda	Leke/5 vjet	15,000
10	Liçense për agjensi nderkombetare udhëtarësh	Leke/5 vjet	40,000
11	Liçense për transport udhëtarësh me taksi	Leke/mjet/5 vjet	20,000
12	Dhënie autorizimi për transport nderqytetëse	Lekë/mjet	2,000
13	License për shërbim të rregullt të specializuar të transportit të udhëtarëve.	Leke/5vjet	20,000
14	Çertifikate për shërbim të rregullt të specializuar të transportit të	Leke/mjet/vit	1,500
15	Çertifikate transport udhëtarësh për llogari të vet	Leke/mjet/vit	1,500

16	Libër udhëtimi për shërbimet e rastit në transportin e udhëtareve	Lekë/bllok	5,000
<b>B</b>	<b>Tarifat e Liçensimit të Transportit të mallrave</b>		
1	Liçense për transport mallrash për trete dhe me qera brenda vendit	Leke/5 vjet	40,000
2	Çertifikate për transport mallrash për trete dhe me qera brenda vendit	Leke/ton/vit	100
3	Çertifikate për transport mallrash për vehte 31 vendit	Leke/ton/vit	100
4	Çertifikate për transport mallrash & udhëtarë	Leke	3,000

### Strukturat përgjegjëse përvjeljen e tarifës:

Për vjeljen e këtyre tarifave ngarkohet Drejtorina e Shërbimeve Publike.

### II.6. Tarifa për Liçensë për njësitë e shitjes me pakicë të lëndëve djegëse

Niveli i tarifës dhe kushtet për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj, përcaktohen me VKM nr.970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”.

*Tabelë 17. Tarifa për autorizim për shitje karburanti*

Nr	Kategoritë	Njesia e matjes	Tarifa për autorizim shitje karburanti
1	Liçence për njesitë të shitjes së lëndës djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre për përdorin nga konsumatorët fundorë	Lekë/license	100,000
2	Licensë për stacionet e shitjes të karburanteve me pakicë (të naftës, benzines dhe nënprodukteve të tyre) për 5 vjet	Lekë/Licensë	1,000,000

### Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifës

Për lëshimin e licenses, faturës dhe vjeljen e kësaj tarife ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike, pas rakordimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore, me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

### II.7. Tarifa për shërbime në institucionet e varësisë

*Tabelë 18. Tarifa nga institucionet e vartësisë*

Nr	Tarifat sipas kategorive	Njësia e matjes	Tarifa e institucioneve të vartësisë
<b>A</b>	<b>Përdorimi i ambjentëve në Pallatinë Kulturës</b>		

1	Salla e leksioneve	Lekë/përdorimi	3,000
2	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë/orëpërdorimi	20,000
3	Salla e madhe e shfaqjeve	Lekë/përdorimi per femije	Falas
4	Për shfaqjet të organizuara nga institucioni përpublikun	Lekë/person	Falas
4	Përdorimi i sallave për zhvillime provash	Lekë/orëpërdorimi	Falas
5	Salla e Galerisë së arteve për ekspozita	Lekë/ditëpërdorimi	3,000
6	Salla e Galerisë së arteve, për piktorët e rinj	Lekë/ditëpërdorimi	Falas
<b>B</b>	<b>Biblioteka Publike e Qytetit</b>		
1	Holli në katin e II	Lekë/ditëpërdorimi	7,000
12	Holli në katine III (salla Fishta)	Lekë/ditëpërdorimi	3,000
23	Hapje kartelexuesi të rregullt	Lekë/kartelë/vit	100
3	Hapje kartelexuesi për femijet	Lekë/kartelë/vit	0
<b>C</b>	<b>Muzeu&amp;Memoriali</b>		
1	Për të rritur	Lekë/biletë	200
2	Për fëmijët	Lekë/biletë	100
<b>D</b>	<b>Klubi Sportiv "Besëlidhja"</b>		
9	Për dhënie në shfrytëzim të mjediseve sportive	Lekë/aktivitet	50,000

### Strukturat përgjegjëse përvjeljet e tarifave:

Për vjeljen e kësaj tarife ngarkohen strukturat/institucionet përgjegjëse që i kanë në administrim.

### II.8. Tarifa e ujit

Tarifës së ujit (për ujsjellsat që nuk janë në varesi të Ndermarrjes Ujeshes Kanalizime SH.a), i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brendaterritorit e Bashkisë Lezhë.

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së ujit janë të shprehura si më poshtë:

*Tabelë 19. Tarifa e ujit*

Tarifa për ujin	Njesia	Niveli tarifes ujit
Ujsjelles me rrjedhje të lire, pa mates	lekë/familje/ muaj	300
Ujsjelles me mates	leke/m <sup>3</sup>	30
Ujsjelles me ngritje mekanike, pa mates	lekë/familje/ muaj	500
Uji për vaditjes	lekë/orë pune	500

Tarifa e ujit të pijshëm për institucionet arsimore, çerdhet, kopshtet si dhe për institucionet fetare të jenë në nivelin 50 % të tarifave normale.

### Strukturat përgjegjëse përvjeljet e tarifave:

Ngarkohen për vjeljen e detyrimeve punonjësit e Njesive Administrative që kanë në varesi administrative ujsjellesin.

**Menyra e pageses:** Pagesa per tarifen e ujit te pishem behet deri ne 30 dite nga dita e faturimit.

### **Kapitulli III: Te ardhurat jo tatimore**

#### **III.1. Të ardhura nga qerata e objekteve**

Baza ligjore: Vendim i KM nr. 54 datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore,( I ndryshuar) dhe Udhëzimi Nr. 6756, date 3.9.2015 për zbatimin e VKM nr. 54, date 5.2.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar.

Të ardhurat nga qerata paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë.

Qeraja e tregut 200 leke /m<sup>2</sup>/ muaj.

Qera objektësh të rikonstruktuar 300 leke /m<sup>2</sup>/ muaj.

Qera objektësh të parikonstruktuar 200 leke /m<sup>2</sup>/ muaj.

#### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifave:**

Ngarkohet Drejtoria Juridike për lidhjen e kontratës me subjektin që merr me qera objektin. Per vjeljen e kesaj tarife ngarkohet Drejtoria e Finances përgjegjëse që i kanë në administrim.

#### **III.2. Të Ardhura nga Kopshtet dhe Çerdhet**

Kjo tarifë paguhet nga familjarët e fëmijëve që marrin këtë shërbim. Struktura e ngarkuar për llogaritjen dhe arkëtimin e të ardhurave është Drejtoria e Finances.

#### **III.3. Të Ardhura nga Privatizimi**

Baza ligjore për të ardhurat nga privatizimi: VKM nr. 608 datë 05.09.2012 «Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë, të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, VKM Nr. 614, Datë 7.7.2015 "Për përcaktimin e procedurave të privatizimit të banesave dhe objekteve të kthyer në fond banese, me vendime të organeve të qeverisjes vendore, në pronësi të njëjësive të qeverisjes vendore dhe të shtetit, ku janë sistemuar me strehim banorë të pajisur me autorizim nga organet kompetente "

Tarifa e shërbimit administrativ 3000/ leke , per cdo aplikim.

Të ardhurat nga privatizimi paguhen nga përfituesi i pronës.

#### **Strukturat përgjegjëse për vjeljen e tarifave:**

Ngarkohet Drejtoria Juridike, për lëshimin e faturës per arkëtim.

**1. Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë dhe tarifat për dhënie në përdorim me kontratë qeraje të fondit pyjor dhe kullor për ushtrimin e veprimtarive**

**2.**

Baza ligjore: Ligji nr. 9385 date 4.5.2005 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor", të ndryshuar, Neni nr 34, Ligjit nr. 9693, date 19.3.2007 "Për fondin kullor", i ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave" i ndryshuar me VKM Nr.1064, date

22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin nr.391, date 21.6.2006 të këshillit të ministrave “për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”.

## Kapitulli IV: Gjobat

Tabelë 20. Gjobat

Nr	Emertimi	Njesia	Niveli i gjobave
<b>A</b>	<b>Gjopa për dëmtimet dhe ndërhyrjet në infrastrukturen rrugore</b>		
	1.Bllokim rruge dhe trotuari	Leke/ml	20,000
	2.Dëmtim,çarje	Leke/m2	15,000
	3.Ndotje trotuari nga dëmtimi	Leke/m2	15,000
	4.Vjedhje zgare	Leke/cope	15,000
	5.Vjedhje pusete	Leke/cope	20,000
<b>B</b>	<b>Gjopa për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin elektrik rrugor</b>		
	1.Dëmtimin e driçuesve	Leke/cope	20,000
	2.Perdorim i shtyllave si support per montimine reklamave,kapjen e kabllave	Leke/cope	20,000
	3.Ndërhyrjet ne kuadrin e komandimit	Leke/cope	20,000
<b>C</b>	<b>Gjopa per dëmtimet dhe ndërhyrjet ne rrjetin e ujesjellesit</b>		
	1.Lidhje të pamiratuara në tubacion	Leke/cope	20,000
	2.Dëmtim i pusetave	Leke/cope	20,000
	3.Dëmtim i tubacioneve nga punimet qe kryhen me ose pa leje.	Leke/cope	20,000
<b>D</b>	<b>Gjopa për dëmtimet dhe ndërhyrjet ne rrjetin e kanalizimeve te ujrave të bardha</b>		
	Gjobë per mos likujdim ne aftat te takses së ndertesës dhe tarifave te sherbimit public	ditë	0.06% ,jo me shume se 365 dite
	1.Lidhjet e pa miratuara në tubacion	Leke/cope	20,000
	2.Dëmtim i pusetave	Leke/cope	20,000
	3.Dëmtim i tubacioneve nga punimet që kryhen me ose pa leje.	Leke/cope	20,000
<b>E</b>	<b>Gjopa për dëmtim fasade</b>	Leke/m2	5,000
<b>F</b>	<b>Gjopa për dëmtimet dhe ndërhyrjet në hapësirat e gjelbërta dhe ato publike</b>		
	1.Dëmtim,prerje pemësh	Leke/cope	20,000
	2.Zënie hapësire të gjelbërta pa leje	Leke/m2	15,000
	3.Vendosje posterash nga kompanite e ndryshme pa leje	Leke/rast	20,000

	4.Vendosje tabelash,pankartash,banderolash pa leje	Leke/cope	5,000
<b>G</b>	<b>Gjobë për hedhjet materialeve inerte ne vende te pamiratuara</b>	Leke/m3	20,000
<b>H</b>	<b>Gjobë për mos pajisje me leje për tregtim apo sherbim jashtë sipërfaqes së njërive</b>	Leke/rast	20,000

### **Strukturat përgjegjëse për vendosjen dhe vjeljen e gjobave:**

Për vendosjen dhe vjeljen e gjobës, pas evidentimit te kundravajtjes, ngarkohet Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

## **Kapitulli V: Agjentet per mbledhjen e detyrimeve**

**V.1.** Kur e miraton Këshilli i Bashkisë mbledhjen e një takse apo tarife vendore me agjent fiskal, të propozuar nga Kryetari i Bashkisë,agjenti fiskal të shpërblehet në përqindje mbi vlerën e arkëtuar,në masën e përcaktuar me Vendim të Keshillit Bashkisë.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.